

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 114 Rep.
Nr. 246 Kol.

KONTRATË DHURIMI

Në Tiranë sot më datë 05.03 2002 në Dhomën e Notërisë Tiranë para meje noterit Brigjeto Salenç u paraqitën Muhamet Malo i biri i Seferit i datëlindjes 1957, banues në Tiranë, Rruga "Lek Dukagjini", Pallati Nr.11 si dhe Lirim Zalla, i biri i Ademit i datëlindjes 1963, banues në Tiranë Rr. "Reshit Çollaku" Pallati "Bora", shkalla 2 Ap. 3.

Për identitetin e tyre u sigurova me pasaportat e tyre personale respektivisht me numrat: 1768744 dhe 0649082, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët deklaruan se:

1. Në bazë të Vendimit Nr. 1 datë 05.03.2002 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë "Telesport" sh.p.k. është vendosur që ortaku Lirim Zalla ti dhurojë ortakut Muhamet Malo 20% (përqind) të kuotave të kapitalit që ai ka në këtë shoqëri.
2. Me këtë rast Lirim Zalla deklaron se i dhuron Muhamet Malos 20% (përqind) të kuotave të kapitalit të tij që ka në shoqërinë "Telesport" sh.p.k.
3. Zoti Muhamet Malo pranon këtë dhurim të 20% (përqind) të kuotave të kapitalit nga Z. Lirim Zalla.
4. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Z. Muhamet Malo bëhet pronar i 100% (përqind) të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Telesport" sh.p.k., ndërsa Z. Lirim Zalla mbas këtij dhurimi nuk ka asnjë të drejtë apo detyrim ndaj kësaj shoqërie.
5. Detyrimet apo dhe të drejtat që mund të kenë lindur para lidhjes së kësaj kontrate i bart tërësisht Z. Muhamet Malo.

Kjo kontratë pasi u gjet sipas vullnetit të palëve nënshkruhet prej tyre rregullisht.

DHURUESI

PRANUESI I DHURIMIT

LIRIM ZALLA

MUHAMET MALO

Lirim Zalla

Muhamet Malo

NOTER
Brigjeto Salenç

